



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 19 Shtator 2023

Nr: 780

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT 442 ID NGA “KOALICIONI PËR REFORMA, INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË KONSOLIDUARA”, NDAJ Z. AGRON MALAJ, KRYETAR I BASHKISË MAT PËR SHKELJE ADMINISTRATIVE, NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot më datë 19 Shtator 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjen administrative me:

KËRKUES: Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)

SUBJEKT: Z. Agron Malaj, Kryetar i bashkisë Mat

OBJEKT: Shqyrtimi administrativ ndaj personit përgjegjës për shkelje administrative, për postime në faqen e rrjetit social “Facebook”

BAZA LIGJORE: Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

K O N S T A T O J :

Nga Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), është depozituar denoncim për të cilën denoncuesi pretendon se institucione publike kanë publikuar postime apo kanë ripostuar publikime me përmbajtje partiake në faqet zyrtare të tyre, të cilat përbëjnë përdorim të burimeve publike.



Subjekti i denoncuar është z. Agron Malaj, Kryetar i bashkisë Mat.

Denoncimi është marrë nëpërmjet provave link dhe materialeve fotografike, të administruara në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, nga “Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara” (KRIIK).

Denoncimi regjistruar me nr. 442 ID ndaj Bashkisë Mat, me kërkues KRIIK, ku pretendohet si më poshtë vijon:

“Bashkia Mat në postimet e kryera në faqen zyrtare të bashkisë ka përdorur slogane ose hashtag që lidhen dhe identifikojnë drejtpërsëdrejt subjektin zgjedhore “Partia Socialiste”. Duke u vendosur, përdor dhe reklamuar institucione publike dhe drejtuesit e tyre në faqet zyrtare në Facebook.” “Panair Agro-Kulturor në #Burrel. Faleminderit nga zemra të gjithë pjesëmarrësve dhe shumë suksese në punën e tyre. Aktivitete të tilla I duhen më shumë komunitetit tonë dhe ne do të krijojmë kushtet e nevojshme për ta kthyer në traditë këtë nismë. #Mat #Zgjedhjetvendore2023 #VetëmPërpara #KurrëMëMbrapa”

Prova link:

<https://www.facebook.com/BashkiaMat/posts/pfbid037HFesNKirkxx6zUyËj6LEv8srQoHxqGpL3axcjH3d7MmQmgËXFMZ3qu8gu3EAJVZI>

Neni 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, u shqyrtuan paraprakisht çështjet dhe u vlerësuan se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për t’u nisur hetimi administrativ.

Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundravajtjet administrative”, kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Në vijim të procedurës administrative, filloi shqyrtimi administrativ, duke verifikuar provat si dhe duke kërkuar informacion në lidhje me publikimet e postuara me përmbajtje elektorale dhe slogane elektorale.

Në vijim të hetimit administrativ, nëpërmjet postës elektronike, më datë 18.5.2023, personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike i është kërkuar informacion në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi. Nga struktura përgjegjëse pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nuk u administrua asnjë përgjigje nga personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Bashkinë Mat.

Për shkak të kompleksitetit të çështjes, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nëpërmjet vendimit nr. 707, datë 18.07.2023 “Për zgjatjen e afatit të denoncimeve regjistruar me nr. 442 ID, 446 ID, 447 ID dhe 448 ID, për shkelje administrative për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”, ka vendosur zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimit regjistruar me nr. 442 ID.

Në vijim të shqyrtimit administrativ, pas konsultimit me të gjitha provave dhe fakteve, më datë 27 Korrik 2023, nëpërmjet postës elektronike, palëve në këtë proces i është kërkuar paraqitja e pretendimeve përfundimtare përpara se të vijohet me vendimmarrje.

Bashkia Mat, nëpërmjet shkresës administruar nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me nr. 5412 prot., më datë 24.5.2023, ndër të tjera bën me dije se: *“Ju sqarohet se nga faqja zyrtare e Bashkisë Mat, nuk janë bërë publikime të tilla që identifikojnë partitë politike. Linku mbi të cilin janë ngritur pretendimet është marrë nga faqe personale dhe jo nga faqja zyrtare e Bashkisë Mat.”*

Në fazën e përfundimit të hetimit administrativ pas administrimit të përgjigjeve me lëndë “Kërkese për informacion” dhe pas verifikimit të faqes së rrjetit social “Facebook”, nën emrin Bashkia Mat, , u konstatua se postimet me përmbajtje elektorale dhe ripostimet, objekt shqyrtimi janë fshirë.

Për sa më sipër, të ndodhur në kushtet ku referuar provave dhe fakteve mbi denoncimin nuk gjendemi para shkeljes administrative të legjislacionit në fuqi, vlerësoj se duhet të pushohet shqyrtimi administrativ ndaj z. Agron Malaj, kryetar i bashkisë Mat.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenet 91, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

V E N D O S:

1. Pushimin e shqyrtimit administrativ ndaj z. Agron Malaj, Kryetar i bashkisë Mat.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

